



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:016259

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05389757

KPPP.nr.907/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbare të kreditorit Y.K., me adresë në Fushë Kosovë, Dardania 2, lagjja Apollonia A26, hyrja 2 nr.20, kundër debitorit “CIMA” Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë, rruga “Dardania”, me NUI: 810796328, pas shqyrtimit paraprak të prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.01/22 të datës 05.01.2022, të lejuar nga Përmbaresi Privat Isa Shala me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 06.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë për të vendosur në çështjen juridike përmbare në mes të kreditorit Y.K. me adresë në Fushë Kosovë, dhe debitorit “CIMA” Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë.
- II. Për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PPP.nr.90/22, të datës 27.01.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbare, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës.

Gjykata, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës KPPP.nr.907/23 në çështjen përbarimore të kreditorit Y.K. kundër debitorit “CIMA” Sh.P.K, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës dhe gjeti se Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas prapësimit lidhur me këtë çështje.

Meqenëse në rastin konkret çështja përbarimore zhvillohet në mes të kreditorit si person fizik dhe debitorit si person juridik, me kërkesë për pagesën e borxhit sipas dokumentit përbarues-aktit noterial me LRP.nr.3937/2021 të datës 11.03.2021, ndërsa me nenin 13 par.1 nën par. 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15) përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar: *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, dhe nën par. 1.2 të po të njëjtit nen, ku përcaktohet se: *“të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*, që rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate për vendosje, pasi që në rastin konkret në cilësinë e kreditorit është personi fizik, ndërsa në cilësinë e debitorit është personi juridik.

Ndërsa duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat dhe nenin 5 par. 5 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore i cili përcakton se *“ Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedurën përbaruese sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përbaruesi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim ne Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit..”* kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega në Fushë Kosovë, duke qenë se selia e debitorit është në territorin e Komunës së Fushë Kosovës.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.907/23, me datë 06.02.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.